




Edicioni 1
Nr. 2



Newsletter

Shqipëria në çdo stinë.
Përjetojeni. Zbuloni. Ndani.




ALBANIA
ALL SENSES
AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT

www.albania.al

Newsletters

Mars - Prill 2026

Prodhim i Agjencisë Kombëtare të Turizmit



Agjencia Kombëtare e Turizmit

© 2025 Erald Hallil

All Rights Reserved



ITB Berlin 2026

ALBANIA ALL SENSES:
SHQIPËRIA NJË DESTINACION GJITHËVJETOR

▶ Berlin, Gjermani

Experience in VR 3D

Albania

ITB Berlin 2026

AlbaniaAllSenses

QËLLIMI :

Shqipëria u prezantua me një prani të konsoliduar në ITB Berlin 2026 nga 3-5 mars, i cili këtë vit shënoi 60-vjetorin e themelimit, duke mirëpritur qindra vizitorë dhe profesionistë të industrisë nga e gjithë bota. Me një qasje të qartë strategjike dhe një narrativë të unifikuar destinacioni, vendi u pozicionua si një nga tregjet më dinamike në rritje në Europë.

ÇFARË PROMOVUAM:

Nën konceptin "Albania All Senses", Shqipëria prezantoi një ofertë të strukturuar që reflekton trendet globale të turizmit, si qëndrueshmëria, përvojat autentike, produktet premium dhe diversifikimi sezonal. Kjo qasje synoi forcimin e partneriteteve B2B, zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe rritjen e prezencës në tregjet prioritare.

March, 2026

Momente nga ITB, Berlin



Tur 2-ditor në Përmet

Itinerare

ZBULONI ITINERARET TONA




DITA 01:

Shëtitje në qytetin e Përmetit dhe zbulim i kulinarisë autentike vendase

DITA 02:

Banjat e Bënjës – Ura e Kadiut – Kanioni i Langaricës – Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës – Dangëlli” – Lumi Vjosë





TEA

Tourism Events of Albania



SKANO QR CODE PËR TË GJETUR TEA!



Kërkon të kalosh një fundjavë interesante me shoqërinë, të dëgjosh një grup muzikantësh në koncert, të ulesh në një restorant mikpritës, apo të vizitosh një kala? E di ku i gjen të gjitha këto? Pikërisht tek TEA. Një aplikacion që mbledh gjithçka në telefonin tënd. Nga festivalet, tek teatrot, aktivitete për fëmijë, sportet, agroturizmat e shumë informacione të tjera. Mbi 7,000 evente të listuara, nga një event i traditës në Veri, tek festivali muzikor më i dëgjuar pranë bregdetit në Jug, fundjava juaj është gati me vetëm një "Click".

 www.events.albania.al

Album nga eventet Mars - Prill



Salvator Dali



Muze-x



Bilbilat e vegjël të Shkodrës




Lule t'bukra ka Tirona



Art'Zanatet

Në TEA gjeni...





Samiti i Diasporës Prill, 2026

Tiranë, Shqipëri

"Autenticiteti dhe zhvillimi i turizmit digjital do të sigurojnë qëndrueshmërinë e turizmit edhe në vitet e ardhshme."

Kështu u shpreh Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Znj. Zana Çela, në panelin "Roli i Diasporës në zhvillimin e turizmit", gjatë ditës së dytë të Samitit të IV të Diasporës në Tiranë me datë 15 prill 2026.

Znj. Çela theksoi se Shqipëria po përjeton aktualisht një moment shumë të rëndësishëm në zhvillimin e saj turistik. Shqipëria ka gjithçka për të qenë një histori suksesi afatgjatë në turizëm. Detyra jonë është ta tregojmë këtë histori në mënyrën e duhur - me krenari, me vizion dhe me një qasje që e bën të kuptueshme dhe tërheqëse për botën. Ajo nënvizoi se Agjencia Kombëtare e Turizmit ka luajtur një rol kyç në promovimin e vendit tonë në botë, duke u fokusuar në autenticitetin e Shqipërisë, si dhe përmes një pakete të integruar promovimi, që përfshin elementë tradicionalë ashtu edhe digjitalë.



Momente nga
MUSE-X

WWW.ALBANIA.AL

Faleminderit

